



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:065852

Datë: 11.11.2024

Numri i dokumentit: 06430659

Ac.nr.593/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Nora Bllaca-Dula, kryetare e kolegjit, Enes Mehmeti dhe Hidajete Gashi-Alaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.G nga P....., të cilin me autorizim e përfaqëson S.M.N, avokate nga P....., kundër të paditurës Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore e Ministrisë së Drejtësisë, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti, pagesa e shujtave ditore, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1182/22, të datës 20.12.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 05.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit me seli në Prizren, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1182/22, të datës 20.12.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.1182/22, të datës 20.12.2022, ka vendosur si vijon: *“I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F. G nga P.....*

II. DETYROHET e paditura, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, që paditësit F.G, që në emër të shujtave ditore për 225 ditë të pranisë në punë prej datës 01.01.2021 deri më 31.12.2021, të ia kompensojë shumën prej 450.00 € (katërqind e pesëdhjet euro), dhe atë me kamatë ligjore prej 8 % në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga dita e paraqitjes së padisë (04.04.2022) deri në pagesën definitive, në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore shumë prej 124 € (njëqind e njëzet e katër) euro në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm”.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor, ka paraqitur ankesë e paditura, përmes të autorizuarës së saj, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës të aprovojë ankesën dhe të ndryshohet aktgjykimi duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësit.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur paditësi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi përmes të autorizuarit të tij me datën 04.04.2022 pranë gjykatës së shkallës së parë ka ushtruar padi kundër të paditurës, për kompensimin e shujtave për praninë në punë, me të cilës ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija e paditësit dhe atë nga 2 euro për ditët e pranisë në punë, për periudhën nga data 01.01.2021 e deri me 31.12.2021, ka shkuar në punë gjithsej 225 ditë pune në shumën e përgjithshme prej 450 € nga dita e parashtrimit të padisë me kamatë ligjor 8% e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, jashtë seancës gjyqësore në bazë të nenit 398 të LPK-së, pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.1182/2022 të datës 20.12.2022, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi F.G është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënëse në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim “N..... T.....” në P..... Gjykata, përmes Kontratës së Punës për mësimdhënës me numër protokoli 3/1048-74 të datës 02.03.2016, vërtetoi se paditësi është në marrëdhënie të punës pranë të paditurës, ndërsa përmes vërtetimit të lëshuar nga shkolla ku paditësi punon vërtetoi se paditësi, në periudhën 01.01.2021-31.12.2021 ka prezantuar në punë gjithsej 225 ditë. Andaj meqë këto dokumente janë të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat edhe si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, gjykata ia fali besimin e plotë, e nga të cilat vërtetoi faktin se paditësja ka prezantuar në punë gjithsej 225 ditë në periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, duke ia njohur shumën si në dispozitivin e aktgjykimin të ankimuar.

Lidhur me mënyrën e vendosjes vendimin e bazoi në nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021. Për kamatën ka vendosur konform nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (15.09.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse dhe vendimi për shpenzimet e procedurës kontestimore është bazuar në nenin 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k), n) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) (kuptohet nga referati i ankesës), se nuk ka dhënë arsye bindëse për faktet vendimtare, nuk ka paraqitur qartë se cilat arsye i trajton si të vërteta apo të pavërteta. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, këto pretendimet të autorizuarit të të paditurës janë të pabazuara për arsye se dispozitivi i aktgjyimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjyimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi F.G është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënëse në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim “N.....T.....” në P..... . Gjykata, përmes Kontratës së Punës për mësimdhënëse me numër protokoli 3/1048-74 të datës 02.03.2016, vërtetoi se paditësi është në marrëdhënie të punës pranë të paditurës, ndërsa përmes vërtetimit të lëshuar nga shkolla ku paditësi punon vërtetoi se paditësi, në periudhën 01.01.2021-31.12.2021 ka prezantuar në punë gjithsej 225 ditë.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në aktgjykimin e ankimuar, në mënyrë të drejtë dhe duke bazuar në ligj e ka zbatuar të drejtën materiale, duke u bazuar në nenin 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në aktgjykimin e ankimuar, në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale për arsye se:

Me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni,

përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes*“. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës*”. Me paragrafin 5 përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...*”.

Me nenin 35 paragrafin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021 përcaktohet se: “*Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim*”. Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke vendosur decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e lindjes së të drejtës për parashtrim të kërkesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, që nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadisë së paditësit.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridiko - civil, ndaj paditësit për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit – shujtës gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*”.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke e obliguar të paditurën që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për paditësin për periudhën kohore prej datës 01.01.2021 e deri me datën 31.12.2021, t’ia paguaj shumën prej 450 €, me të drejtë është bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e parashtrimit të kërkesës për kompensimin shpenzimeve të ushqimit për ditët në punë, që rrjedhimisht nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadisë.

Në raport me pretendimin ankimor të paditurit se e njëjta nuk ka mundur të planifikojë në skemën e saj buxhetore, linjë të veçantë për këtë lloj kompensimi, është i pabazuar, ngase një pretendim i tillë nuk e argumenton mos pagesën e pagave jubilarë dhe shujtës ditore, një e drejtë që i takon paditëses.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së dhe Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 449 dhe 452 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.593/2023, me datë 05.11.2024

Kryetare e kolegjit,
Nora Bllaca-Dula, d.v